



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D I M

Nr. 6, datë 30.6.2007

PËR

MIRATIMIN, NË PARIM, TË PËRDORIMIT PËR HIDROENERGJI
TË REZERVAVE UJORE TË LUMIT DEVOLL

Në mbështetje të neneve 6, shkronja "ç", 11, 12, 16, pika 1, dhe 18, paragrafi i parë, të ligjit nr.8093, datë 21.3.1996, "Për rezervat ujore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I:

1. Miratimin, në parim, të përdorimit për qëllime hidroenergjetike të rezervave ujore të kaskadës së lumit Devoll, si më poshtë vijon:
 - a) Kuota e sipërme e shfrytëzimit të jetë rreth 805m mbi nivelin e detit;
 - b) Kuota e poshtme e shfrytëzimit të jetë rreth 100m mbi nivelin e detit (përfshi dhe Banjën);
 - c) Sasia e ujit, që do të depozitohet në rezervuarin e Banjës, të përdoret për prodhimin e energjisë elektrike;
 - ç) Prurja mesatare shumëvjeçare, që do të përdoret për qëllime hidroenergjetike, të jetë nga rreth 15 m³/sek në rreth 50 m³/sek;
 - d) Prodhimi mesatar i energjisë elektrike të jetë nga rreth 930 GWh deri në 1200 GWh.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, që, në zbatim të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006, "Për koncesionet", dhe të vendimit nr.27, datë 19.1.2007, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve", të shqyrtojë propozimet për ndërtimin e HEC-ve mbi lumin Devoll, duke patur parasysh të dhënat e parashikuara në pikën 1, të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Sali Berisha
SALI BERISHA

Lufter XHUVELI

L. Xhuveli
Zëvendëskryetar

dhe

ministër i Mjedisit, Pyjeve,
dhe Administrimit të Ujërave

